



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

PROJEKT-VENDIM

Nr. 3204 Datë 03.03 .2021

**“PËR PËRDORIMIN E FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR
NDIHMËN EKONOMIKE ME FONDE TE BUXHETIT VENDOR PËR VITIN 2021”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore” si dhe në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr . 597 datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, nisur nga situata e zgjatur e pandemisë dhe e pasojave ekonomike dhe sociale që po kalojmë,

PROPOZOJMË:

Të miratohen kriteret e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike **me fonde të buxhetit vendor**, si më poshtë:

1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit me arsyen: Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme.
2. Për të gjitha familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike sipas këtij fondi, duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social - ekonomik në familje nga administratori shoqëror sipas shtojcës 2 të VKM nr.597 datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
3. Masa e ndihmës ekonomike për familjet përfituese nga ky fond llogaritet në të njëjtën mënyrë sipas përlllogaritjes së masës së strukturës së familjes, për familjet përfituese të ndihmës ekonomike.

KRYETARI

Pjerin NDREU

